

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

TOTAL GAMING ALBANIA SH.A



Përmbajtja

PREAMBULA	3
Titulli I EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA	3
Neni 1 Data e Themelimit, Emërtimi dhe Themeluesi	3
Neni 2 Selia dhe Adresa Elektronike	3
Neni 3 Objekti i Aktivitetit	4
Neni 4 Kohëzgjatja	4
Titulli II KAPITALI	4
Neni 5 Kapitali	4
Neni 6 Kalimi dhe Regjistrimi i Aksioneve	4
Neni 7 Zmadhimi i Kapitalit	5
Neni 8 Zvogëlimi i Kapitalit	5
Titulli III ORGANET KRYESORE DREJTUESE TË SHOQËRISË	6
Neni 9 Organet Kryesore Drejtuese	6
Titulli IV VENDIMMARRJA	6
Neni 10 Vendimmarrja	6
Neni 11 Regjistri i Vendimeve	7
Titulli V KËSHILLI I ADMINISTRIMIT DHE ADMINISTRATORI	7
Neni 12 Përbërja dhe Emërimi i Këshillit të Administrimit	7
Neni 13 Emërimi i Administratorit	8
Neni 14 Kompetencat e Këshillit të Administrimit	8
Neni 15 Kompetencat e Administratorit	9
Neni 16 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit	10
Neni 17 Kufizime për Votimin	11
Titulli VII AUDITIMI LIGJOR DHE VITI FINANCIAR	11
Neni 18 Viti Financiar	11
Neni 19 Auditimi Ligjor	12
Neni 20 Dividendi & Kapitalizimi i Fitimeve	12
Titulli IX PRISHJA DHE LIKUIDIMI	12
Neni 21 Prishja	12
Neni 22 Likuidimi	12
Titulli X DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	13



Neni 23 Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve13



Në këtë dokument:

- "Aksionar(ë)" janë personat, emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si mbajtës të aksioneve;
- "Ligji i Zbatueshëm" nënkupton çdo akt pjesë të legjislacionit; çdo ligj, vendim, urdhër ose dekret; akt ligjor ose nënligjor, rregull ose rregullore; ose çdo akt tjetër që ka efekt ligjërish të detyrueshëm, siç mund të ndryshohet herë pas here në Republikën e Shqipërisë;
- "Ligji Tregtar" nënkupton Ligjin Nr. 9901, data 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar;
- "Shoqëria" nënkupton shoqërinë aksionare të themeluar sipas këtij statuti.

PREAMBULA

Sot, më 04.12.2023, Ilir Qazimi shtetas shqiptar, lindur më Elbasan, Shqipëri, në 31.07.1975, mbajtës i letërnjoftimit me nr. H50731104R, nëpërmjet këtij dokumenti krijon një shoqëri aksionare në përputhje me këtë akt dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Titulli I

EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emërtimi dhe Themeluesi

- 1.1 Shoqëria themelohet dhe organizohet si shoqëri aksionare me një nivel, në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
- 1.2 Shoqëria emërtohet "Total Gaming Albania Sh.a" shkurtimisht TGA Sh.a. (në vijim referuar si "Shoqëria").
- 1.3 Themeluesi dhe Aksionari i Vetëm i Shoqërisë është Ilir Qazimi.

Neni 2

Selia dhe Adresa Elektronike

- 2.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:
"Rruga Todi Shkurti, Nr. 8/4, Kodi postar 1004, Tirane."
- 2.2 Këshilli i Administrimit të Shoqërisë mund të krijojë dhe/ose mbyllë, shoqëri bija, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Objekti i Aktivitetit

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë janë aktivitetet në lidhje me lojërat e fatit, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës që rregullon këto aktivitete, si mund të ndryshojë kohe pas kohe.
- 3.2 Për të përmbushur objektivin e përshkruar më sipër, Shoqëria do të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme, duke përfshirë çdo funksion të përcaktuar me akte nënligjore, rregullore, dhe udhëzime, sipas Ligjit të Zbatueshëm për objektin e aktivitetit të Shoqërisë.
- 3.3 Pavarësisht nga sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të dobishëm dhe/ose të nevojshëm për realizimin e objektivit të saj të veprimtarisë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Titulli II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 4,000,000 (katër milionë lekë), i përbërë nga 4,000 (katër mijë aksione/aksione të zakonshme me vlerë nominale të aksionit 1000 (një mijë) lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar është në para dhe është në pronësi të aksionarit të vetëm i fiton atë në bazë të kontributit fillestar gjatë themelimit të Shoqërisë:

Z. Ilir Qazimi , që zotëron 4,000 (katër mijë aksione/aksione të zakonshme me vlerë nominale të aksionit 1000 (një mijë) lek secili dhe që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë.
- 5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet sipas dispozitave ligjore që parashikon Ligji Tregtar për aksionarin e vetëm .
- 5.4 Kapitali përbëhet nga aksione të zakonshme. Aksionet janë nominale dhe të pandashme.

Neni 6
Kalimi dhe Regjistrimi i Aksioneve

- 6.1 Aksionet dhe të drejtat lidhur me to mund të fitohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e Shoqërisë me themelimin e Shoqërisë ose nëpërmjet procedurës së rritjes së kapitalit në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm;
 - Blerjen e aksioneve në përputhje me përcaktimet e përcaktuara me Ligjin e Zbatueshëm dhe këtë Statut;



- Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Mënyrave të tjera të parashikuara me ligj.
- 6.2** Në rast të transferimit kontraktual të aksioneve, aksioni mund të bartet përmes kontratës në formë të shkruar ose elektronike në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe duhet të regjistrohet më pas në Regjistrin e Aksioneve. Kontrata rregullon kushtet e transferimit ndërmjet palëve në të, duke përfshirë por pa u kufizuar në, momentin e transferimit të titullit të aksionit dhe të pagesës së çmimit.
- 6.3** Pronësia e aksionit dhe ndryshimet e mëvonshme në lidhje me këtë aksion do të regjistrohen në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë me kërkesë me shkrim ose elektronike nga Aksionari pretendues ose ndonjë person i autorizuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara me Ligjin e Zbatueshëm, këtë Statut ose aktet e brendshme të Shoqërisë të miratuara nga Këshilli Administrimit.
- 6.4** Regjistri i Aksioneve është në përgjegjësinë e Administratorit dhe përmban informacionin e mëposhtëm:
- Emri i Aksionarit;
 - Adresa;
 - Numri, lloji dhe vlera nominale e aksioneve të zotëruara nga Aksionari;
 - Data e regjistrimit pranë Regjistrin të Aksioneve.
- 6.5** Administratori do të kujdeset që të sigurojë regjistrimet e kërkuara të aksioneve dhe ndryshimet e pronësisë nga transferimi i aksioneve në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

Neni 7

Zmadhimi i Kapitalit

- 7.1** Aksionari i Vetëm mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë pa kufi, në përputhje me kushtet e përcaktuara me Ligjin Tregtar, këtë Statut dhe aktet e brendshme të shoqërisë të miratuara nga Këshilli i Administrimit.
- 7.2** Vendimi i Aksionarit të Vetëm për zmadhimin e kapitalit do të parashikojë kushtet dhe procedurën për pjesëmarrjen e zotëruesve të aksioneve të reja në fitimet e biznesit, si dhe kushtet e tjera për zmadhimin e kapitalit në masën që lejohet dhe është në përputhje parashikimet e Ligjit të Zbatueshëm.

Neni 8

Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1.** Aksionari i Vetëm mund të zvogëlojë kapitalin deri në masën që ai të mos cenojë kapitalin minimal, në varësi të kërkesave të publikimit dhe regjistrimit të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe ligje të posaçme që rregullojnë fushën përkatëse të aktivitetit të Shoqërisë.

Titulli III
ORGANET KRYESORE DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 9
Organet Kryesore Drejtuese

- 9.1 Shoqëria është e organizuar si shoqëri aksionare me një nivel.
- 9.2 Organet kryesore drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë:
- a. Aksionari i Vetëm;
 - b. Këshilli i Administrimit;
 - c. Administratori(ët).
- 9.3 Shoqëria ka në strukturën e saj edhe organe shtesë të nevojshme dhe/ose ndihmëse për të funksionuar. Këto organe, krijohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat e akteve dhe rregulloreve të brendshme.

Titulli IV
VENDIMMARRJA

Neni 10
Vendimmarrja

- 10.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Aksionari i Vetëm.
- 10.2 Aksionari i Vetëm është përgjegjës, duke përfshirë por pa u kufizuar në, për vendimet në lidhje me sa vijon:
- a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimin e Statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
 - d. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe audituesit ligjor;
 - e. miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) dhe d) më sipër;
 - f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - j. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;



- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj; dhe
- n. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në këtë Statut dhe Ligjin e Zbatueshëm.

10.3 Aksionari i Vetëm vendos pasi të ketë marrë dokumentet përkatëse së bashku me raportet e Këshillit të Administrimit dhe raportin e auditorit.

Neni 11

Regjistri i Vendimeve

- 11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Aksionari i Vetëm do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, përmbajtja e të cilit nuk mund do të fshihet apo ndryshohet. Në veçanti, do të regjistrohen vendimet e mëposhtme:
- a. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
 - c. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - d. vendimet për investime;
 - e. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 11.2 Nëse një vendim nuk është regjistruar si duhet në Regjistrin e Vendimeve, ai do të konsiderohet i pavlefshëm.

Titulli V

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT DHE ADMINISTRATORI

Neni 12

Përbërja dhe Emërimi i Këshillit të Administrimit

- 12.1 Shoqëria Tregtare është e organizuar sipas sistemit të administrimit me 1 (një) nivel.
- 12.2 Këshilli i Administrimit përbëhet nga tre (3) anëtarë ose nga një numër më i lartë tek, por në çdo rast numri i anëtarëve nuk mund të jetë më i madh se 21 (njëzet e një).
- 12.3 Anëtarët e Këshillit të Administrimit (këtu e në vijim referuar edhe si “**Anëtarë Këshilli/Drejtorë**”) emërohen nga Aksionari i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar, për një mandat deri në maksimumi 3 (tre) vite dhe mund të ri-emërohen për mandate të tjera. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen në çdo kohë nga Aksionari i Vetëm.
- 12.4 Këshilli i Administrimit zgjedh dhe emëron nga anëtarët e saj Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Këshillit. Kryetari dhe Zëvendëskryetari mund të shkarkohen nga mbajtja e këtyre pozicioneve në çdo kohë nga Këshilli i Administrimit.

12.5 Këta individë emërohen si të parët Anëtarë, Kryetar dhe Zëvendëskryetar të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë:

1. **Z. Enkel Tasho**, shtetas shqiptar, lindur më 19.07.1984, në Tiranë dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I40719061R;
2. **Z. Bledar Mejdani**, shtetas shqiptar, lindur më 20.04.1980, në Vlorë dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I00420206T;
3. **Z. Fatjon Vasili**, shtetas shqiptar, lindur më 02.12.1982, në Novoselë, dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I21202132P.

Neni 13

Emërimi i Administratorit

- 13.1 Këshilli i Administrimit do të emërojë në përputhje me Ligjin Tregtar një ose më shumë individë si Administrator(ë) dhe përfaqësues ligjor(ë) të shoqërisë tregtare për një mandat deri në maksimumin 3 (tre) vjet. Këta individë mund të rizgjidhen për një numër mandatesh të tjera të pakufizuara. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet sipas shumicës së kërkuar, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga Këshilli i Administrimit.
- 13.2 Administratori është anëtar i Këshillit të Administrimit (*drejtor ekzekutiv*). Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratorë për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.
- 13.3 Individu i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë Shoqërisë:
Z. Ilir Qazimi, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, më 31.07.1975 dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H50731104R.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

- 14.1. Këshilli i Administrimit ka këto të drejta dhe detyra:
- a. të japë direktiva për Administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - c. të përgatisë, me kërkesë të Aksionarit të Vetëm, marrjen e masave, që janë në kompetencë të këtij të fundit, t'i rekomandojë atij vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e tij;
 - d. të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - e. të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;


- f. të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Aksionarit të Vetëm, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- g. të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar Aksionarit të Vetëm, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve.
- h. të emërojë dhe të shkarkojë administratorët;
- i. të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
- j. të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- k. të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% (pesë) për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- l. të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në Ligjin e Zbatueshëm dhe këtë Statut.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit

15.1. Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë ;
- b. të përfaqësojë Shoqërinë;
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- d. të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'iu paraqitur më pas për miratim nga Aksionari i Vetëm;
- e. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- f. të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë Tregtare, sipas parashikimeve të Ligjit të Zbatueshëm;
- g. të raportojë përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;



- h. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin e Zbatueshëm, këtë Statut apo vendim të Këshillit të Administrimit.

Neni 16

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- 16.1** Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar dhe qeverisjes së mirë të Shoqërisë, por të paktën çdo tre muaj, përveçse kur Aksionari i Vetëm përcakton intervale të ndryshme.
- 16.2** Mbledhja e Këshillit të Administrimit thirret nga Kryetari i Bordit ose në mungesë, paaftësi apo pamundësi të tij nga Zëvendëskryetari i Bordit, nëpërmjet një njoftimi me shkrimi ose elektronik ("Njoftimi") të paktën 5 (pesë) ditë pune para, të drejtuar të gjithë anëtarëve të këshillit që kanë të drejtë të marrin një njoftim të tillë, në adresat e tyre zyrtare të regjistruara pranë Shoqërisë për këtë qëllim. Njoftimi duhet të përcaktojë dhe përfshijë qëllimin e mbledhjes, rendin e ditës të propozuar, dokumentet e nevojshme që do të shqyrtohen, datën dhe vendin e takimit. Një mbledhje e Këshillit të Administrimit mund të kryhet edhe nëpërmjet një njoftimi me afat më të shkurtër se ai i lartpërmendur, me kusht që të gjithë Anëtarët e Këshillit ta japin miratimin e tyre me shkrim/mënyrë elektronike dhe që miratimi i tyre të bashkëngjitet me Procesverbalin e Mbledhjes.
- 16.3** Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në zyrën qendrore të Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme dhe të aksesueshëm për anëtarët e këshillit.
- 16.4** Vendimet e Këshillit të Administrimit janë të vlefshme në rast se në mbledhje janë të pranishëm ose marrin pjesë në format e tjera të lejuara më shumë se gjysma e anëtarëve dhe nëse për vendimet ka votuar shumica e anëtarëve të pranishëm, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga Anëtarët përkatësisht.
- 16.5** Në rast se mbledhja e Këshillit nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e mësipërme dhe procedurat e votimit nuk janë respektuar siç duhet, Këshilli i Administrimit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se janë të pranishëm të gjithë Anëtarët dhe votojnë unanimisht pavarësisht parregullsive.
- 16.6** Mbledhja e Këshillit të Administrimit mund të zhvillohet dhe Anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë apo mjete të tjera, që përmbushin standardet dhe kërkesat e mëposhtme për aq sa është e nevojshme që të arrihet qëllimi i kërkuar:
- Garantoni identifikimin e duhur të Anëtarëve të Këshillit;
 - Garantoni sigurinë e komunikimit;
 - Garantoni komunikim të qartë;



- Siguron mundësinë për të votuar duke garantuar standardet kryesore të votimit sikurse për anëtarët e tjerë.
- 16.7 Çdo Anëtar Këshilli që nuk mund të jetë i pranishëm ose nuk mund të marrë pjesë në Mbledhje, mund të autorizojë me shkrim ose çdo formë tjetër ligjore një nga Anëtarët e tjerë të këshillit për ta përfaqësuar, vepruar dhe votuar në emër të tij në mbledhjen e këshillit të administrimit.
- 16.8 Vendimi me shkrim apo në formë elektronike i nënshkruar rregullisht nga të gjithë Anëtarët e Këshillit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit të thirrur dhe mbajtur rregullisht.
- 16.9 Këshilli i Administrimit mund të miratojë unanimitisht rregulla të detajuara për mbarëvajtjen dhe procedurat e mbledhjes dhe votimit.

Neni 17

Kufizime për Votimin

- 17.1 Anëtari i Këshillit nuk do të marrë pjesë në votim në mbledhjet e Këshillit të Administrimit për çështje në të cilat, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, ka një interes ose detyrim të qenësishëm që është apo që mund të jetë në konflikt me interesin e Shoqërisë, përveçse kur parashikohet ndryshe në Ligjin e Zbatueshëm.
- 17.2 Anëtari i Këshillit nuk përlogaritet në kuorumin e mbledhjes për vendimmarrje në të cilën e ka të kufizuar të drejtën e votimit.
- 17.3 Nëse në një mbledhje shtrohet çështja për të drejtën e votimit të një anëtari, Kryetari i Këshillit të Administrimit merr vendim përfundimtar për çdo rast, përjashtuar rastit të tij personal për të cilën vendimi merret nga Zëvendëskryetari.


Titulli VII

AUDITIMI LIGJOR DHE VITI FINANCIAR

Neni 18

Viti Financiar

- 18.1 Viti Financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti kalendarik.
- 18.2 Administratori dhe Këshilli i Administrimi janë përgjegjës për mbajtjen e librave kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe me aktet nënligjore të zbatim të tij.



Neni 19
Auditimi Ligjor

- 19.1 Auditimi ligjor i Shoqërisë kryhet nga një auditues ligjor i jashtëm dhe i pavarur në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe sipas kërkesave të përcaktuara nga Ligji Tregtar, legjislacioni për auditimin ligjor.
- 19.2 Aksionari i Vetëm, me propozim të Këshillit të Administrimit, emëron një auditues ligjor për të qenë Audituesi Ligjor i Jashtëm i Shoqërisë për një periudhë të specifikuar që në çdo rast nuk duhet të jetë më shumë se 4 (katër) vite radhazi në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.
- 19.3 Personi i mëposhtëm caktohet si Audituesi Ligjor i parë i Shoqërisë:
- Edison Troshani Pf, NUIS L82009019J, me numër licence 487, datë 04.11.2021, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Dervish Bej Mitrovica, Pallati Kristi Co Nr.6.

Neni 20
Dividendi & Kapitalizimi i Fitimeve

- 20.1 Në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar, Aksionari i Vetëm mund të vendosë shpërndarjen e fitimit në formën e dividendit, vetëm në rast se garantohet rregullshmëria e sipërpërmendur dhe posaçërisht kërkesat mbi fondet e veta dhe rezervat e Shoqërisë.
- 20.2 Aksionari i Vetëm mund të vendosë që fitimit të mos shpërndahen dhe dividendi të mos paguhet, në mënyrë që të përdoret për qëllime të tjera në interes të Shoqërisë Tregtare.


Titulli IX
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21
Prishja

- 21.1 Shoqëria mund të priset me vendim të Aksionarit të Vetëm ose me vendim gjykate sipas rastit në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.
- 21.2 Përveçse kur vijohet me procedurën e falimentimit, prishja e Shoqërisë Tregtare mund të vijojë me ndjekjen e procedurave për likuidimin vullnetar .
- 21.3 Procedura e falimentimit kryhet në përputhje me legjislacionin për falimentimin.

Neni 22
Likuidimi

- 22.1 Aksionari i Vetëm me propozim të Këshillit të Administrimit mund të vendosë hapjen e procedurave të likuidimit vullnetar dhe emëron likuidatorin/ët.
- 22.2 Procedura për likuidimin vullnetar kryhen në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm



22.3 Përgjatë likuidimit emërtimi i Shoqërisë mban shënimin “*në likuidim vullnetar*”.

Titulli X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 23.1 Ky dokument është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij do të kryhet dhe do të ketë efekt në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 23.2 Dispozitat e Ligjit Tregtar do të zbatohen për çështje të cilat nuk rregullohen nga ky dokument.
- 23.3 Në rast të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve që mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij dokumenti, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

Aksionari i Vetëm

Ilir Qazimi

